



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PARTESHIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Parteshit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Parteshit (Komunës së Parteshit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Parteshit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Parteshit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Mos protokollimi i faturave të pranuar
- B1 Mangësi në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ dhe mosfunksionimi i sistemit e-pasuria.
- B2 Mos përpilimi i Planit për subvencionim të OJQ-ve.
- B3 Vonesa në pagesën e faturave.
- B4 Mosverifikimi i pronave për qëllime të tatimit në pronë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Parteshit.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Parteshit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Parteshit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Parteshit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Parteshit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në fusha të rëndësishme si: mungesë e planit për suvencionimin e OJQ-ve, mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€ në sistemin e-pasuria, mosprotokollimi i faturave, vonesa në pagesë, mosëverifikim të pronave, dhe dobësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe pesë (5) të përsëritura. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mos protokollimi i faturave të pranuar

**Gjetja** Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF- Shpenzimi i Parave Publike, neni 24 Pranimi dhe pagesa e faturës, paragrafi 1.3 përcakton se Fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Kemi vërejtur se në dhjetë (10) raste ishin realizur pagesa bazuar në fatura të cilat nuk ishin Protokolluar nga Organizata.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve të organizatës gjatë procesit të protokollit dhe kontrolleve të dobëta nga menaxhmenti.

**Ndikimi** Mos protokollimi i faturave të pranuar rritë rrezikun që ato mos të regjistrohen në kohë, të mos raportohen detyrimet sipas faturave dhe të shkaktohen vonesa në pagesën e tyre.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm, për qarkullim të dokumentacionit dhe të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislacionit në fuqi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B1 - Mangësi në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ dhe mosfunksionimi i sistemit e-pasuria

**Gjetja** Sipas rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare neni 6, paragrafi 3 "pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet, në sistemin "e-pasuria".

Komuna e Parteshit edhe gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur që të regjistroj pasuritë me vlerë nën 1,000€ në sistemin e-pasuria. Zyrtari i pasurisë regjistron dhe mirëmban evidencën e pasurisë përmes programit Exel. Totali i pasurisë jokapitale i paraqitur në RVF është 8,295€.

Kjo ka ndodhur për arsye të mos marrjes së veprimeve për funksionalizimin e sistemit e-pasuria.

**Ndikimi** Sistemi jo funksional i e-pasurisë sipas kërkesave rregullative për menaxhim të pasurive, ndikon në mos-permbushjen e kërkesave ligjore për regjistrimin e pasurisë. Me tej, mos funksionimi i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë dhe mos shpalosjes të drejtë të tyre në pasqyrat vjetore financiare.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria dhe të sigurojë se vlera e pasurisë nën 1,000€ në PFV prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B2 - Mos përpilimi i Planit për subvencionim të OJQ-ve**

**Gjetja** Rregullorja e MF-së-nr.-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 9 paragrafi 1 përcakton se Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Për vitin 2024, Komuna nuk e kishte përgatitur planin vjetor për subvencionimin e OJQ-ve.

Kjo ka ndodhur për arsye të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi** Mungesa e planit vjetor për subvencionimin e OJQ-ve tregon se menaxhmenti i komunës nuk ka bërë përpjekje të duhura për menaxhim efikas të subvencioneve.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të ndikojë te zyrtarët përgjegjës që plani vjetor i subvencioneve të hartohet sipas objektivave financiare të Komunës, me qëllim që të jetë në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave**

**Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimit të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Obligimet e papaguara për vitin 2024 në total arrijnë shumën prej 108,417€ që krahasuar me vitin 2023 janë rritur për rreth 3.5%. Bartje të obligimeve të papaguar kemi vërejtur edhe për periudhat paraprake.

Identifikuam se në katër (4) raste, faturat në vlerë totale prej 40,657€, të paraqitura në pasqyra, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 22 ditë deri në 112 ditë.

Sipas zyrtareve të komunës obligimet nuk janë paguar kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve.

**Ndikimi** Pagesa me vonesë e obligimeve ndaj furnitorëve mund ta ekspozojë Komunën para padive për mos pagesë me kohë të obligimeve dhe kjo do të shkaktojë kosto shtesë buxhetore për shkak të kamatave dhe shpenzimeve të përbarimit.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen brenda afatit dhe obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mosverifikimi i pronave për qëllime të tatimit në pronë**

- Gjetja** Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.
- Në vitin 2024, me kërkesë të qytetarëve është azhurnuar regjistri i objekteve të regjistruara, mirëpo nuk është bërë inspektim i pasurive të paluajtshme siç përcaktohet me ligjin për tatimin mbi pronën e paluajtshme. Sipas zyrtareve të Komunës kjo ka ndodhur për arsye të mungesës së stafit.
- Ndikimi** Inspektimi jo i plotë i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të arkëtueshmet

Komuna e Parteshit në PFV e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 461,863€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 204,377€, ushtrimi i veprimtarisë 50,089€, shitja e mbeturinave 201,039€ dhe shitja e shërbimeve të faturimit të ujit 6,358€.

#### Çështja B5 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 461,863€ të cilat janë zvogëluar në krahasim me vitin 2023 por vlera e tyre është ende e lartë.

Kjo ka ndodhur për arsye se Komuna nuk ka marrë veprime ligjore për shlyerjen e borxheve si dhe mos menaxhimi i duhur i llogarive të arkëtueshme.

**Ndikimi** Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitor mund të shkaktoj probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të siguroj se po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitoreve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull paraqesim një përmbledhje të burimeve të financimit buxhetor, shpenzimeve të realizuara dhe të hyrave të mbledhura, të ndara sipas burimeve dhe kategorive ekonomike. Informacioni është ilustruar përmes tabelave më poshtë:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,549,954</b>	<b>1,654,004</b>	<b>1,637,534</b>	<b>1,724,818</b>	<b>1,268,367</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,378,360	1,349,118	1,344,575	1,485,853	985,045
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	4,763
Të bartura nga viti i kaluar	0	44,182	43,800	31,272	23,986
Të hyrat vetanake	171,594	249,691	240,069	206,092	86,030
Donacionet e jashtme	0	11,014	9,090	1,602	168,544

Buxheti final është rritur për 104,050€ krahasuar me buxhetin fillestar.

Kjo rritje ka ardhur si rezultat i të hyrave vetanake dhe të bartura nga viti paraprak dhe donacioneve të jashtme.

Në vitin 2024, janë shpenzuar gjithsej 1,637,534€, ose 99% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet janë më të ulëta për rreth 5%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,549,954</b>	<b>1,654,004</b>	<b>1,637,534</b>	<b>1,724,818</b>	<b>1,268,367</b>
Pagat dhe mëditjet	1,311,451	1,283,231	1,282,209	1,169,620	896,053
Mallrat dhe shërbimet	177,845	229,593	224,860	285,857	153,615
Komunalitë	37,000	37,274	37,223	45,534	42,178
Subvencionet dhe transferet	17,000	24,107	16,959	43,568	81,458
Investimet Kapitale	6,658	79,799	76,283	180,239	95,064

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 104,050€. Kjo rritje është rezultat kryesisht i shtesave në mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe në investime kapitale.

Shpenzimet kryesore janë realizuar në këto kategori:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 28,220€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 99.9% të buxhetit dhe përbëjnë 78.3% të shpenzimeve totale. Ato janë rritur me 9.63% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 51,748€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet për këtë kategori kanë arritur afër 98% të buxhetit, përbëjnë 13.73% të shpenzimeve totale dhe janë zvogëluar për 21.34% krahasuar me vitin paraprak.
- Buxheti final për komunalitë është rritur lehtë për 274€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ka qenë 99.9%, përbëjnë 2.27% të shpenzimeve totale, dhe janë zvogëluar me 18.26% krahasuar me vitin e kaluar.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 7,107€. Shpenzimet kanë arritur në 70.4% të buxhetit, përbëjnë 1.04% të shpenzimeve totale, dhe janë zvogëluar me 61.07% krahasuar me vitin 2023.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 73,141€. Shpenzimet kanë qenë 95.6% të buxhetit, përbëjnë 4.66% të shpenzimeve totale, dhe janë zvogëluar me 57.68% krahasuar me vitin paraprak.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2024 ishin në vlerë 264,640€, të cilat përfshijnë të hyrat nga tatimi në pronë, taksa për ndërrim të destinimit të pronës dhe legalizimin e objekteve, regjistrim të automjeteve, çertifikata, etj. Krahasuar me vitin 2023, të hyrat janë rritur për 8.09% apo për 19,803€.

Kjo rritje tregon një përmirësim në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës dhe menaxhimin më efikas të burimeve financiare, veçanërisht në kategorinë e të hyrave jo tatimore, të cilat janë rritur me 13,101€ krahasuar me vitin paraprak.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>171,594</b>	<b>171,594</b>	<b>264,640</b>	<b>244,837</b>	<b>114,803</b>
Të hyrat tatimore	43,987	43,987	77,694	70,992	53,989
Të hyrat jo tatimore	127,607	127,607	186,946	173,845	60,814

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, pesë (5) rekomandime nuk janë adresuar ende dhe një (1) rekomandim konsiderohet i mbyllur, siç është paraqitur në tabelën më poshtë, rreshti Nr. 1. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria dhe të sigurojë se vlera e pasurisë nën 1,000€ në PFV prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndikojë te zyrtarët përgjegjës që plani viotor i subvencioneve të hartohet sipas objektivave financiare të Komunës, me qëllim që të jetë në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen brenda afatit dhe obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha masat e nevojshme për verifikimin e pronave, në përputhje me dispozitat ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj se po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika Kosovo  
Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Komuna e Parteshit , Opština Partesh, Municipality of Partesh  
**OPŠTINA PARTESH**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës Partesh, për vitin 2024;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Data: 20.maj,2025.

Dragan Petković  
Kryetar i Komunës Partesh



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.